BASHKIA SHKODËR

# TRANSPORTI PUBLIK

# 2020 – 2022

## Programi Buxhetor: 04570 – Transporti publik

# PËRSHKRIMI I PROGRAMIT

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzimet buxhetore për sigurimin e shërbimit të transportit publik lokal, mbikëqyrjen dhe disiplinimin e tij nga shoqëritë private (miratimi i tarifave për pasagjerët, i orëve dhe shpeshtësisë së shërbimeve, si dhe ndërtimin ose funksionimin e sistemeve dhe strukturave jotregtare të transportit publik lokal.

## Shpenzimet e Programit buxhetor 2017 – 2022

| Kodi | Fakt 2017 | Fakt 2018 | I Pritshmi 2019 | Plan 2020 | Plan 2021 | Plan 2022 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 04570 | 12,293 | 9,549 | 18,459 | 13,494 | 13,620 | 13,620 |




## Shpenzimet e Programit sipas klasifikimit ekonomik

| | Shpenzimet korrente | Investimet |
|---|---|---|
| **Fakt 2017** | 4,921 | 7,372 |
| **Fakt 2018** | 3,202 | 6,347 |
| **I Pritshmi 2019** | 6,732 | 11,727 |
| **Plan 2020** | 6,594 | 6,900 |
| **Plan 2021** | 6,637 | 6,983 |
| **Plan 2022** | 6,637 | 6,983 |



## Treguesit Kyç të Performancës

**Qëllimi i programit**

Lëvizshmëri e sigurtë, e mirë orientuar për banorët dhe vizitorët

Ofrimi i një shërbimi transporti publik cilësor ne sherbim te qytetarëve te Bashkisë Shkodër

**Objektivi 1**

Permiresimi i levizshmerise urbane për një siguri dhe cilësi jetese më të mirë

| Treguesit e rezultatit | *Njësia Matëse* | *2018* | 2019 | Synimet<br>2020 | 2021 | 2022 | Trendi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Rritja e sigurisë në rrugë për këmbësorët dhe pedaluesit | *Numri i tabelave për sinjalistikën vertikale (rritja vjetore në %)* | | | **8%** | **15%** | **0%** | ↑ |
| | *Numri i bumpeve për sinjalistikën vertikale (rritja vjetore në %)* | | **25%** | **-50%** | **40%** | **37%** | ↑ |

**Qëllimi i programit**

Lëvizshmëri e sigurtë, e mirë orientuar për banorët dhe vizitorët

Ofrimi i një shërbimi transporti publik cilësor ne sherbim te qytetarëve te Bashkisë Shkodër

**Objektivi 2**

Ofrimi i një shërbimi transporti publik cilësor ne sherbim te qytetarëve te Bashkisë Shkodër

| Treguesit e rezultatit | *Njësia Matëse* | *2018* | 2019 | Synimet<br>2020 | 2021 | 2022 | Trendi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Rritja e komunikimit nëpërmjet transportit publik | *Numri i linjave të transportit publik urban dhe interurban (rritja vjetore në %)* | | **0%** | **25%** | **0%** | **0%** | ↑ |
| | *Numri i mjeteve të transportit publik urban dhe interurban (rritja vjetore në %)* | | **8%** | **15%** | **3%** | **3%** | ↑ |
| Përmirësimi i transportit publik | *Numri i biletave te shitura (rritja ne %)* | | **4%** | **4%** | **4%** | **5%** | ↑ |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| *Përkrahja e kategorive si nxënës, studentë dhe kategorive të veçanta që përfitojnë sipas dispozitave ligjore (rritja në %)* | **3%** | **3%** | **3%** | |

## TË DHËNAT E PROGRAMIT

| Fakt 2018 | I Pritshmi 2019 | Plan 2020 | Plan 2021 | Plan 2022 |
|---|---|---|---|---|
| **NUMRI I TABELAVE PËR SINJALISTIKËN VERTIKALE** | | | | |
| | ***1200*** | ***1300*** | ***1500*** | ***1500*** |
| **NUMRI I BUMPEVE PËR SINJALISTIKËN VERTIKALE** | | | | |
| **36** | **45** | **24** | **40** | **55** |
| **NUMRI I LINJAVE INTERURBANE TË TRANSPORTIT PUBLIK** | | | | |
| | **10** | **10** | **10** | **10** |
| **NUMRI I LINJAVE URBANE TË TRANSPORTIT PUBLIK** | | | | |
| | **2** | **5** | **5** | **5** |
| **NUMRI I MJETEVE TË TRANSPORTIT INTERURBAN** | | | | |
| | ***46*** | ***48*** | ***50*** | ***52*** |
| **NUMRI I MJETEVE TË TRANSPORTIT URBAN** | | | | |
| | ***9*** | ***15*** | ***15*** | ***15*** |

**Projektet kryesore të investimeve**

| Titulli dhe përshkrim i shkurtër i projektit | Fillon | Mbaron | Viti i zbatimit | | % e realizimit nga fillimi deri në fund të vitit 2019 | Programi buxhetor |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Fonde të kontraktuara | Fonde të planifikuara | | |
| Lëvizshmëria dhe sinjalistika | 2020 | 2022 | 0 | 20,866 | 0% | 04570 |

## Aktivitetet Kryesore

Aktivitetet kryesore të parashikuara për t'u realizuar gjatë 2020 – 2022 janë:

- Permiresimi i levizshmerise urbane për një siguri dhe cilësi jetese më të mirë
- Permiresim te impaktit mjedisor nepermjet stimulimit te transportit publik dhe tradites se perdorimit te biçikletes.

# FUNKSIONI 04: Çështjet ekonomike

## Nënfunksioni 045: Transporti

### *Programi 04570:*
### *Transporti publik*

| **Vështrim i përgjithshëm** | | |
|---|---|---|
| Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor brenda juridiksionit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. | | |
| Emri i Programit | Përshkrimi i programit | Përshkrimi i programit |
| 04570 | Transporti publik | • Kontraktimi i shoqërive private të transportit për sigurimin e shërbimeve të transportit publik lokal;<br>• Mbikëqyrje dhe rregullim i shërbimeve të transportit publik lokal të shoqërive private (miratimi i tarifave për pasagjerët dhe i orëve dhe shpeshtësisë së shërbimeve etj.);<br>• Prodhim dhe përhapje e informacionit të përgjithshëm, orareve etj. të operacioneve të sistemit publik lokal të transportit;<br>• Grante, hua ose financime për të mbështetur funksionimin, ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e sistemeve dhe strukturave të transportit publik lokal. |

| Qëllimet | Objektivat | Treguesit e rezultatit | Synimet | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Levizshmeri e sigurt, e mire orientuar per banoret dhe vizitoret. Ofrimi i një shërbimi transporti publik cilësor ne sherbim te qytetarëve te Bashkisë Shkodër. Permiresim te impaktit mjedisor nepermjet stimulimit te transportit publik dhe tradites se perdorimit te bicikletes. | **O1.** Permiresimi i levizshmerise urbane për një siguri dhe cilësi jetese më të mirë | Rritja e sigurisë në rrugë për këmbësoret dhe pedaluesit | **2019** | **2020** | **2021** | **2022** |
| | | *Numri i tabelave për sinjalistikën vertikale (rritja vjetore në %)* | | **8%** | **15%** | **0%** |
| | | *Numri i bumpeve për sinjalistikën vertikale (rritja vjetore në %)* | **25%** | **-50%** | **40%** | **37%** |
| | | | Implementimit i projektit te studimit te planit te trafikut.<br><br>Shtimi i sipërfaqes të rrugëve të vijezuar ne qytet dhe Nj.A dhe realizimi i këtij proçesi në 2 herë në vit. Reduktimi i orarit te levizjes se mjeteve nga 10 orë në 12 orë në 24 orë. | Shtimi i sipërfaqes të rrugëve të vijezuar ne qytet dhe Nj.A dhe realizimi i këtij proçesi nga 1 në 2 herë në vit. Reduktimi i orarit te levizjes se mjeteve nga 10 orë në 12 orë në 24 orë nëpërmjet vendosjes së kufizuesve të trafikut (pistona) | Shtimi i sipërfaqes të rrugëve të vijezuar ne qytet dhe Nj.A dhe realizimi i këtij proçesi nga 1 në 2 herë në vit. Reduktimi i orarit te levizjes se mjeteve nga 10 orë në 12 orë në 24 orë nëpërmjet vendosjes së kufizuesve të trafikut (pistona) | Shtimi i sipërfaqes të rrugëve të vijezuar ne qytet dhe Nj.A dhe realizimi i këtij proçesi nga 1 në 2 herë në vit. Reduktimi i orarit te levizjes se mjeteve nga 10 orë në 12 orë në 24 orë nëpërmjet vendosjes së kufizuesve të trafikut (pistona) |
| | | Gjatesia e rrugeve lokale urbane (km) për çdo sinjalistikë rrugore (vertikale) | 0.171 | 0.158 | 0.146 | 0.137 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **O2.** Ofrimi i një shërbimi transporti publik cilësor ne sherbim te qytetarëve te Bashkisë Shkodër | Rritja e komunikimit nëpërmjet transportit public<br>- *Numri i linjave të transportit publik urban dhe interurban (rritja vjetore në %)* | 0% | 25% | 0% | 0% |
| | | - *Numri i mjeteve të transportit publik urban dhe interurban (rritja vjetore në %)* | 8% | 15% | 3% | 3% |
| | | Përmirësimi i transportit publik<br><br>- *Numri i biletave te shitura (rritja ne %)*k | | 4% | 4% | 4% |
| | | - Pasagjer x km *shërbim* për km2 ne zonat urbane ne dite | 2,876 | 3,045 | 3,215 | 3,384 |
| | | - *Përkrahja e kategorive si nxënës, studentë dhe kategorive të veçanta që përfitojnë sipas dispozitave ligjore (rritja në %)* | | 3% | 3% | 3% |

| **Të dhënat e programit** | | | **Vitet** | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | **2019** | **2020** | **2021** | **Trendi** |
| **1** | Numri i linjave të transportit publik: | interurban | 10 | 10 | 10 | 10 |
| | | urban | 2 | 5 | 5 | 5 |
| | | **Totali** | 12 | 15 | 15 | 15 |
| **2** | Numri i mjeteve të transportit | interurban | 46 | 48 | 50 | 52 |
| | | urban | 9 | 15 | 15 | 15 |
| | | **Totali** | 55 | 63 | 65 | 67 |
| 5 | Numri i njerëzve të mbështetur / subvencionuar për transportin publik | | 500 | 500 | 500 | 500 |

| **Projekte të rëndësishme** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kodi i projektit** | **Titulli dhe përshkrim i shkurtër i projektit** | **Buxheti 2020 në mijë/lekë** | **Buxheti 2021 në mijë/lekë** | **Buxheti 2022 në mijë/lekë** |
| P04570.O1.A1 | Lëvizshmeria dhe sinjalistika | 10,494 | 10,620 | 10,620 |
| P04570.O2.A1 | Shërbimi i transportit urban | 3,000 | 3,000 | 3,000 |

| Informacion financiar në mijë lekë | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Vitet** | **Viti 2017** | **Viti 2018** | **Viti 2019** | **Viti 2020** | **Viti 2021** | **Viti 2022** |
| Tavani i përgjithshëm i programit | | | | 13,494 | 13,620 | 13,620 |
| Shpenzimet bruto | 12,293 | 9,549 | 18,459 | 13,494 | 13,620 | 13,620 |
| Të ardhurat e programit | 6,708 | 5,319 | 5,750 | 15,133 | 11,558 | 14,017 |
| Shpenzimet neto | 5,585 | 4,230 | 12,709 | (1,639) | 2,062 | (397) |
| Pagat dhe sigurimet shoqërore | | | | | | |
| Investimet kapitale | | | | 6,900 | 6,983 | 6,983 |

| **Komente** |
|---|
| **Programi 04570: Transporti publik,** ka si burim financimi te ardhurat e veta te bashkise. Mbulimi i shpenzimeve neto eshte 100% nga te ardhurat. Pjesen me te madhe te shpenzimeve e zene shpenzimet kapitale me rreth 51.1% ne vitin 2020, 51.3% ne vitin 2021 dhe 51.3% ne vitin 2022. Shpenzimet korrente zene 48.9% ne vitin 2020, 48.7% ne vitin 2021 dhe 48.7 % ne vitin 2022. |

| Nr.1 | **P04570.O1.A1:** Lëvizshmëria dhe sinjalistika | **Funksioni 4:** Çështje ekonomike<br>**N/Funksioni 045:** Transporti<br>**Llojet e programit: 04570:** Transporti publik |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

a. Lëvizhmëria

- Është realizuar shërbimi i sinjalistikës horizontale dhe vertikale: Është realizuar vijëzimi i rrugëve kryesore të qytetit, vijëzimi i parkingjeve, parkingjet për persona me aftësi ndryshe, korsitë e biçikletave dhe vijëzime të këmbësorëve në degëzimet kryesore.
- Për sinjalistikën vertikale në gjithë qytetin janë vendosur rreth 1,170 tabela të llojeve të ndryshme. Eshtë realizuar zëvendësimi i sinjalistikës së dëmtuar si dhe plotësimi i saj në qytet dhe në njësitë administrative, kryesisht në plazhin e Velipojës. Eshtë bërë vendosja e kufizuesve të shpejtësisë (bumeve).
- Shërbimi i sinjalistikës është realizuar edhe në njësitë e tjera administrative kryesisht në Nj.A Velipojë, para fillimit të sezonit të plazhit por edhe në zonat e banuara të njësive administrative Guri Zi, Bërdicë, Postribë etj.
- Në të gjitha rrugët e rikonstruktuara me financimet e Bashkisë Shkodër është bërë plotësimi me sinjalistikë horizontale e vertikale sipas parashikimeve në projekt.
- Është në proces realizimi i studimit të trafikut për lëvizshmërinë dhe semaforët.

**Situata e vlerësuar:**

- Trafik i ngarkuar si rezultat i qarkullimit të automjeteve, në akset kryesore dhe në qendër të qytetit, i cili shpeshherë paraqet raste të drejtuesve të mjeteve të pandërgjegjshëm, të cilët kalojnë kufijtë e shpejtësisë së lejuar.
- Nevoja për plotësim me sinjalistikë për kufizim shpejtësie për rritjen e sigurisë rrugore, për shkak të papërgjegjshmërisë së drejtuesve të mjeteve në pika të caktuara.
- Nevoja për përmirësim të mëtejshëm të infrastrukturës dhe rritjen e sigurisë për lëvizjen me biçikleta si dhe promovimi i pedalimit.
- Përdorimi i mjeteve të transportit publik nuk ka qenë në nivelin optimal. Për rrjedhojë, përdorimi i automjeteve personale nuk ka pësuar rënie.
- Dëmtime të qëllimshme të sinjalistikës.
- Përmirësimi i sinjalistikës në njësitë e reja administrative ku ka mungesë të theksuar të sinjalistikës horizontale e vertikale.

**ii. Synimi i projektit**

Të rritet cilësia dhe siguria e jetës së qytetarëve

- Implementimi studimit të sinjalistikës së lëvishmërisë urbane për gjithë territorin administrativ të Bashkisë Shkodër
- Rritja e sigurisë në rrugë për këmbësorët dhe pedaluesit përmes shërbimeve të mirëmbajtjes dhe investimeve.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. **Lëvizshmëria**

**Viti 2020**

- Rritja e sigurisë dhe lehtësisë së lëvizjes së qytetarëve.
- Monitorimi i lëvizjes së mjeteve private në rrugët kryesore të qytetit.
- Në përputhje me planin të bëhet kompletimi me sinjalistikë horizontale dhe vertikale të rrugëve të qytetit sipas ndryshimeve në infrastrukturë.
- Përmirësimi i sinjalistikës vertikale dhe horizontale për këmbësorët, invalidët dhe qarkullimin e mjeteve.
- Rritja dhe mirëmbajtja e linjave të pedalimit brenda qytetit.

**Viti 2021 - 2022**

- Vazhdimi i implementimit të studimit të planit të trafikut.
- Vendosja e semaforëve në varësi të projekt- studimit për përmirësimin e lëvizjes së mjeteve
- Përmirësimi i sinjalistikës horizontale me bojra plastike me jetëgjatësi në qytet dhe njësitë administrative
- Studimi mbi vendosjen e bumeve sipas ndryshimit të infrastruktures së qytetit.
- Shtimi i vendqëndrimit të biçikletave sipas një studimi të mirëfilltë të ndyshimeve të infrastruktures në rrugët e qytetit.
- Studim për vendosjen e parkingjeve të automjeteve të kontrolluara nga Bashkia.
- Mirëmbajtja dhe përmirësimi i sinjalistikës horizontale dhe vertikale në bashkëpunim me sektorin e policisë rrugore.

**2.Sinjalistika**

**Viti 2020**

Janë parashikuar shpenzimet për sinjalistikën horizontale e vertikale në bazë të preventivave përkatës. Parashikimi për bazë materiale për mirëmbajtjen e sinjalistikës horizontale dhe vertikale është bërë duke u bazuar në

| |
|---|
| eksperiencën e viteve të kaluara dhe pajisjeve me të cilin realizohet shërbimi. Në zërat kryesorë të shpenzimeve përfshihen:<br>Gjatë vitit 2020 do të përmirësojmë Sinjalitikën horizontale dhe vertikale. Për këtë do të realizojmë:<br>- Blerje materiale të nevojshme për sinjalistikën horizontale dhe vertikale<br>- Blerje bojë rrugore bikomponente sprajt, gjithsej 2300 kg;<br>- Furnizim e vendosje e tabelave rrugore të ndryshme gjithsej 100 copë;<br>- Pajisje sigurie rrugore gjatë punës për vendosjen e sinjalistikës horizontale dhe vertikale.<br>- F.V Kufizues shpejtësie ( bumpe gome);<br>- Investim në përmirësimin e sinjalistikës rrugore horizontale dhe vertikale sipas planit që përcakton studimi i sinjalistikës dhe lëvizshmërisë urbane.<br>- Plotësimi me sinjalistikë ujore në plazhe për rritjen e sigurisë së pushuesve dhe mirëmbajtja e saj gjatë gjithë sezonit.<br>Bashkia Shkodër do të vazhdojë implementimin e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe realizimin e investimeve të propozuara sipas planit të studimit të sinjalistikës dhe lëvizshmërisë urbane.<br>Për këtë planifikohen shpenzime operative të mirëmbajtjes dhe investime në sinjalistikë. |
| **b) Rezultatet që prisni** |
| • Rritja e sigurisë në rrugë dhe në hapësirat publike.<br>• Kushte lehtësuese dhe nxitje për përdorimin e biçikletave si dhe vendqëndrimin e tyre.<br>• Demotivim për përdorimin e automjeteve private.<br>• Një qytet me ajër më të pastër, me njerëz më aktivë e më të shëndetshëm,si dhe më të sigurtë nga aksidentet. |

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Drejtoria e Shërbimeve publike, ndjekjes së Investimeve dhe Infrastrukturës<br>Drejtoria e Financës. | Bashkia e Shkodrës |

e) Shpenzimet e llogaritura

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2020** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Subv | Kapitale |
| A.1. | Investim në përmirësimin e sinjalistikës rrugore horizontale dhe vertikale | **4,000** | | | | | 4,000 |
| A.2. | F.V Kufizues shpejtësie ( bumpe gome ) | **2,100** | | | | | 2,100 |
| A.3. | Blerje materiale për sinjalistikë horizontale dhe vertikale | **3,182** | | | 3,182 | | |
| A.5 | Shërbim mirëmbajtje për makinat e vijëzimit | **140** | | | 140 | | |
| A.6. | Shpenzime për karburant për dy makinat e vijëzimit | **272** | | | 272 | | |
| A.7 | Blerje materiale për sinjalistikë ujore | **800** | | | | | 800 |
| | **Shuma 2020** | **10,494** | | | **3,594** | | **6,900** |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2021** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Subv | Kapitale |
| A.1.1 | **Mobiliteti** | **10,620** | | | 3,637 | | 6,983 |
| **Shuma 2021** | | **10,620** | | | **3,637** | | **6,983** |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2022** | | Totali ( mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Subv | Kapitale |
| A.1.1 | **Mobiliteti** | **10,620** | | | 3,637 | | 6,983 |
| **Shuma 2022** | | **10,620** | | | **3,637** | | **6,983** |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit**<br>Gjatë vitit 2020, 2021, 2022 | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investimeve dhe Infrastrukturës;<br>Njësia e Prokurimit<br>**Institucioni likujdues:** Bashkia Shkodër |

| | | |
|---|---|---|
| Nr.2 | **P04570.O2.A1:**<br>Shërbimi i Transportit Urban | **Funksioni 4:** Çështje ekonomike<br>**N/Funksioni 045:** Transporti<br>**Llojet e programit: 04570:** Transporti publik |

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Shërbimi urban qytetas realizohet në linjat:
Linja 1 (Bahçallëk- Fermentim- Bahçallëk) e cila realizohet me 50 cikle në ditë me frekuencë 15 minuta paradite dhe 25 minuta pasdite.
Linja 2 (Qendër- Shirokë- Zogaj) e cila shërbehet 4 herë në ditë sipas orareve të miratuara, 3 nga të cilat me destinacion deri në Zogaj.
Krahas shërbimit qytetas në Bashkinë Shkodër realizohet shërbimi rrethqytetës me linja të rregullta që lidhin Njësitë Administrative me Bashkinë Qendër. Shërbimi kryhet me operatorë ekonomik të liçencuar nga Bashkia Shkodër sipas frekuencave të miratuara:

- Shkodër – Velipojë miratuar me Vendimin e Këshillit të Qarkut nr 32 datë 19.08.2004
- Shkodër – Dajç miratuar me VKB nr. 11, datë 09. 06 .2016
- Shkodër–Trush miratuar me Vendimin e Këshillit të Qarkut nr 45 datë 30.12.2014
- Shkodër – Gur i Zi miratuar me Vendimin e Këshillit të Qarkut nr 5 datë 24.02.2009
- Shkodër – Ana e Malit miratuar me Vendimin e Këshillit të Qarkut nr 14 datë 17.06.2013
- Shkodër – Postribë miratuar me VKB nr. 11, datë 09. 06 .2016
- Shkodër – Shalë miratuar me VKB nr. 11, datë 09. 06 .2016
- Shkodër – Rrethina me 3 linja (Shkodër - Bleran – Bardhaj, Shkodër – Grudë e Re – Gucijë e Re, Shkodër – Shtoj i Ri – Shtoj i vjetër ) miratuar me VKB nr. 56, datë 02. 11 .2016.

**Situata e vlerësuar:**

- Trafik i rënduar në akse të ndryshme, i cili redukton shpejtësinë e transportit urban, si dhe ndikon negativisht në respektimin e frekuencave, duke demotivuar rrjedhimisht qytetarët në përdorimin e tij.
- Zënia e vendqëndrimeve nga parkimi i jashtëligjshëm i automjeteve.
- Dëmtimi i sinjalistikës ekzistuese, si dhe nevoja për streha vendqëndrimesh cilësore, aty ku mungojnë.
- Informaliteti që cënon transportin e rrjetit urban dhe linjave të rregullta

**ii. Synimi i projektit**

- Funksionimi i linjave urbane ekzistuese dhe i linjave të reja.
- Funksionim normal të linjave të transportit nga qyteti në drejtim të njësive administrative dhe anasjelltas.
- Përcaktimi i vendqëndrimeve në përshtatje me studimin e planit të trafikut.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

Ofrimi i shërbimit cilësor sipas frekuencave të përcaktuara në linjat:

- Bahçallëk- Fermentim- Bahçallëk
- Qendër– Shirokë– Zogaj. Në kuadër të politikave sociale parashikohet subvencionimi për kategoritë nxënës dhe studentë, ku Bashkia mbulon diferencën e çmimit të biletës dhe abonenti paguan diferencën sipas tarifave të miratuara me VKB.

Ofrimi i shërbimit cilësor sipas frekuencave të përcaktuara në linjat:

- Shkodër – Velipojë
- Shkodër – Dajç
- Shkodër - Trush
- Shkodër – Guri Zi
- Shkodër – Postribë
- Shkodër – Shalë
- Shkodër – Rrethina me 3 linja (Shkodër - Bleran – Bardhaj, Shkodër – Grudë e Re – Gucijë e Re, Shkodër – Shtoj i Ri – Shtoj i vjetër

Monitorimi për zbatimin e frekuencave, orareve, vendqëndrimeve, në përputhje me kontratat e nënshkruara me operatorët, për secilën linjë sipas përcaktimeve të Urdhëresave dhe në sistemin e monitorimit të miratuar.

b) Rezultatet që prisni

- Funksionim normal të linjave ekzistuese, duke kërkuar bashkëpunimin e Policisë Rrugore.
- Krijimi i mundësive të operatorëve të interesuar për ofrimin e shërbimit në tre linja të reja për qytetin e Shkodrës.
- Shtim të përdoruesve të transportit urban, nëpërmjet respektimit rigoroz të cikleve dhe orareve.
- Zbatimi dhe nxitja e mëtejshme e politikave favorizuese ndaj shtresave në nevojë.
- Një qytet me ajër më të pastër, me njerëz më aktivë e më të shëndetshëm,si dhe më të sigurtë nga aksidentet.
- Funksionimi normal i linjave rrethqytetëse që lidhin Njësitë Administrative me Bashkinë Qendër.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Drejtoria e Shërbimeve publike, ndjekjes së Investimeve dhe Infrastrukturës<br>Drejtoria e Financës.<br>Drejtoria e të Ardhurave<br>Operatori i Transportit<br>Nxënës dhe studentë | Bashkia e Shkodrës |

e) Shpenzimet e llogaritura

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2020** | | Totali ( mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Subv | Kapitale |
| A.1 | Subvencione për abonetë e transportit urban | **3 000** | | | | 3000 | |
| **Shuma 2020** | | **3000** | | | | **3000** | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2021** | | Totali ( mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Subv | Kapitale |
| A.1.2 | **Transporti Urban** | **3000** | | | | 3000 | |
| **Shuma 2021** | | **3000** | | | | **3000** | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2022** | | Totali ( mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Subv | Kapitale |
| A.1.2 | **Transporti Urban** | **3000** | | | | 3000 | |
| **Shuma 2022** | | **3000** | | | | **3000** | |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit**<br>Gjatë viteve 2020 - 2022 | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investimeve dhe Infrastrukturës |